



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 07 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1421_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 par.1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 par. 6 dhe Nenin 22 par. 2 nënpar. 2.3 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja gjeneruese nga BRE;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, HC "Soponica" me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, ZK Doganaj në Komunën e Kaçanikut, të datë 18.01.2021, Nr. 068/21 të shoqërisë "2 Korriku" Sh.P.K., me adresë fshati Soponicë, Kaçanik, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 07 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET - Kërkesa e shoqërisë "2 Korriku" SH.P.K., për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017, dhe njëkohësisht Përfundon afati i vlefshmërisë së këtij Vendimi.**

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 11.11.2014 nga shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Hidrocentrali HC "Soponica" ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
- o Bordi i ZRRE-së, pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 28 janar 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_766_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o ZRRE me datë 11.01.2017 nga shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të



lëshuar nga komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.

- Bordi i ZRRE-së, me datë 18 janar 2017 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_880_2017 shoqërisë “2 Korriku” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC “Soponica”, ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut.
- ZRRE me datë 15.01.2019 nga shoqëria “2 Korriku” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V_880_2017 të datës 18 janar 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC “Soponica”, ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 18 janar 2020 për finalizimin e projektit.
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shkurt 2019, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “2 Korriku” SH.P.K., dhe me Vendimin V_1108_2019 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 edhe për një (1) vit, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 17.01.2020 nga shoqëria “2 Korriku” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V_880_2017 të datës 18 janar 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Soponica, ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, edhe për një (1) vit.
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 12 shkurt 2020, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “2 Korriku” SH.P.K., dhe me Vendimin V_1224_2020 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 edhe për një (1) vit, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 18.01.2021 nga shoqëria “2 Korriku” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017, për HC “Soponica”, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, në lokacionin ZK Doganaj, komuna e Kaçanikut, edhe për një (1) vit.
- Shoqëria 2 Korriku SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: për shkak të situatës me pandeminë COVID19, nuk kanë mundur të zhvillojnë ecurin e punëve normale në këtë periudhë, specifikat e terrenit dhe specifikat e projektit, kanë detyruar që të jenë të kujdesshëm pasi që vlera e projekt është e madhe dhe rreziqet është dashur të kihet parasysh, dhe të gjitha këto kanë shkaktuar vonesa në përfundimin e këtij projekti dhe për të cilën kanë kërkuar të t’iu mundësohet shtyrja nga ZRRE-ja për finalizimin e projektit.
- ZRRE me datë 17.09.2021, kanë realizuar vizitën monitoruese në terren, në vend-punishte, në Lokacion Doganaj ZK Doganaj, Komuna e Kaçanikut, për të parë nga afër punimet që janë realizuar brenda periudhës së autorizimit final dhe për të vërtetuar arsyeshmërinë e kërkesës për shtyrje. Pas vlerësimit të situatës në vend punishte, ishte vërtetuar se aplikuesi punimet i



kishte realizuar pjesërisht te vepra e marrjes, tubacioni pjesërisht në proces, hapja e trasesë e hapur, ndërtesa e hidrocentralit në proces, turbinat dhe pjesët përcjellëse të kontaktuara si dhe linja e largpërçuesit.

- o Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final, dëshmime dhe fotove të bashkangjitura nga ana e subjektit juridik, vlerësimin e gjendjes nga Raporti i Monitorimit në vend-punishte dhe duke marr parasysh edhe afatet ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit të kohës së autorizimit final, ka vlerësuar se kërkesa është e pa bazuar dhe se kanë skaduar të gjitha afatet e mundshme të përcaktuara me Rregullën për Procedurën e Autorizimit, andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - o Shoqëria 2 Korriku SH.P.K., ka të drejt të ri-aplikoj për marrje të Autorizimit pas plotësimit të kushteve ligjore sipas dispozitave të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe mund t'iu nënshtrohet vetëm dispozitave ligjore të Kreut III. të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.
- II. Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 i datës 18 janar 2017, shfuqizohet.
- III. Vendim nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.